



Në bazë të nenit 8 dhe 10 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, si dhe kërkesa Nr.02/10536 të dates: 02.05.2025, nr.02/11293 të datës 12.05.2025 nga Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektoriat dhe Emergjencia, Komuna e Kamenicës bënë këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e pozitës për kryerjen e detyrave specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Titulli i pozitës: Një (1) Shofer – Bagerist të Ngarkuesit “Caterpillar-966F” dhe Mini Eskavator “Terex – TC25”.
Nr. i ekzekutuesve: (1) ekzekutues

Orar i punës : 40 në javë

Paga bruto mujore: 550 €.

Lloji i kontratës; (Punë dhe Detyra specifike)

Periudha e angazhimit: (120 ditë)

Detyrat Kryesore:

- Zbaton vendimet dhe direktivat nga eprori apo udhëheqësi i sektorit;
- Mban librin e shenimeve për kilometrzhin dhe dokumentet e tjera të makinerisë;
- Kryen detyra tjera në sigurinë e automjetit;
- Është përgjegjës për dëmet e shkaktuara me automjet nga pakujdesia ose mospershtatja e kushteve të komunikacionit;
- Kandidatët duhen të kenë etikë në punë dhe integritet të lartë pune si dhe të punoj me orar fleksibil;
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyrësi.

Kualifikimi:

Shkolla e mesme, përvoja e punës e dëshirueshme

Patent shoferin kategoria “C” dhe dëshmi për vozitjen e Ngarkueses

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcekur duhet t’i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (kopje) si vijon:

Dëshmi të kualifikimit shkollor

Dëshmi mbi përvojën e punës,

Patent shoferin

Dokumentin e identifikimit.

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Administratën Komunale në objektin e Komunës së Kamenicës.

Afati i aplikimit është (7)ditë, nga dita e shpalljes publike në Web faqen Komunale dhe tabelën e shpalljeve.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit administrativo-teknik të administratës publike lokale”.

Në intervistë me goj-verbale do të ftohen vetëm kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë mbi bazën e kriterëve të shpalljes Publike përmes njoftimit në Web faqe Komunale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, refuzohen.

Kadri RAHIMAJ
Kryetar i Komunës Kamenicës